

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org Org. Jedinica Org. Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-756
Nr. i faqeve Stranica No. pages	-9-
Data: Datum:	05/02/2026
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE / PSO

EMRI I PSO: MARRJA, TRANSPORTI DHE KULTIVIMI BAKTERIAL I STRISHOS SË SYRIT (ITR03/V1.0)

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHIN HAPAT KRYESORË TË MARRJES SË MOSTRAVE, TRANSPORTIT DHE KULTIVIMI BAKTERIAL I STRISHOS SË SYRIT, DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË STANDARDIZUAR PËR IDENTIFIKIMIN E BAKTERIEVE PATOGJENE NË STRISHO TË SYRIT

VERSIONI:1.0
DATA E APROVIMIT: 03/02/2026
AUTOR: MSh/IKSHPK
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NËNHAPAVE:33

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë



MINISTRIA E SHËNDETËSISË

MARRJA, TRANSPORTI DHE KULTIVIMI BAKTERIAL I STRISHOS SË SYRIT (ITR03/V1.0)

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO ËSHTË TË SIGUROJË NJË QASJE TË STANDARDIZUAR PËR MARRJEN E MOSTRËS, TRANSPORTIN DHE KULTIVIMIN E STRISHOS SË SYRIT. PROCEDURA E PËRSHKRUAR DUHET TË ZBATOHET NGA GJITHË PERSONELI LABORATORIK .
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ul style="list-style-type: none"> • LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE; • PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030; • DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË; • EUCAST CLINICAL BREAKPOINTS AND DOSING OF ANTIBIOTICS 2025.
LISTA E SHKURTESAVE	<ul style="list-style-type: none"> • PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE • PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE • EUCAST- EUROPEAN COMMITTEE ON ANTIMICROBIAL SUSCEPTIBILITY TESTING • MRSA-METHICILLIN RESISTANT STAPHYLOCOCCUS AUREUS • ITR- INFEKSIONET E TRAKTIT RESPIRATOR • MALDI-TOF -MATRIX-ASSISTED LASER DESORPTION/IONIZATION TIME-OF-FLIGHT

PROCEDURA

Nr	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mostra merret nga infermieri në klinikë ose nga laboranti në zyrën e pranimit; 2. Mostra transportohet nga laboranti në zyrën e pranimit deri në laboratorin për infeksione të traktit respirator; 3. Laboranti kryen pranimin, përfshirë inspektimin e mostrës, ndarjen, përpunimin dhe ruajtjen e saj sipas kritereve të pranimit dhe refuzimit të mostrave për testim mikrobiologjik në Doracakun e Cilësisë.
[II]	Reagjentët dhe pajisjet që janë të nevojshme për testim:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurohu që të gjitha pajisjet e mëposhtme janë të disponueshme dhe funksional para fillimit të testimit: <ol style="list-style-type: none"> a. Flaka e Bunsenit; b. Ansa bakteriologjike me majë shpuese me dorëz metalike; c. Inkubator 37° C, O₂ ; d. Inkubator 35-37° C 5-10% CO₂; e. Inkubator 24-27 ° C; f. Frigorifer 4-8° C dhe -20° C; g. Turbidometri; h. Pipeta automatike 20-100 µl; i. Vazhduese të pipetës 100 µl; j. Sistemi identifikues automatik (Vitek, MALDI-TOF) k. Vizorja, matësi i zonës së inhibimit. 2. Sigurohu që të gjithë reagjentët e mëposhtëm janë të disponueshëm dhe funksionalë para fillimit të testimit: <ol style="list-style-type: none"> a. H₂O₂ 3 %; b. Disqet e Bacitracinës (0.04 njësi); c. Disqet e Antibiotikëve; d. Kiti për ngjyrosjen Gram; e. Alkool 70 % dhe 96%; f. Kiti komercial i përcaktimit antigjenik të grupeve Lancefield të Streptokokut; g. NaCl 0.9%;

		<ul style="list-style-type: none"> h. Testi i Koagulazës; i. Testi i Optohinës; j. Testi i Oksidazës. <p>3. Sigurohu që të gjitha materialet e mëposhtme janë të disponueshëm dhe funksionalë para fillimit të testimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Mediumet ushqyese; b. Ansa bakteriologjike një përdorimëshe; c. Dorëza Nitrile një përdorimëshe S,M, L; d. Qese Biohazard dhe laps-ngjyrë e përhershme; majë e dyfishtë; e. Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM); f. Pako akulli, çantë transporti.
[III]	Veprimet laboratorike të marrjes dhe transportit të mostrës	<ol style="list-style-type: none"> 1. Marrja e mostrave për diagnozën e infeksioneve të syrit është e vështirë, sepse zakonisht materiali i marrë për mostrim është në sasi të vogël dhe ka prani të një numri të kufizuar të mikroorganizmave; 2. Mostrimi bëhet me nga dy strisho që merren nga të dy sytë; 3. Përdore burimin e dritës apriori egzamino për të lokalizuar vendet e inflamuar dhe eksudatin në regjionin e syrit; 4. Të specifikohet për çfarë mostre bëhet fjalë: mostër nga konjuktiva, kornea, mostra akuoze apo vitroze dhe a është marrë nga syri i majtë apo i djathtë; 5. Paraprakisht strishoja duhet të njomet në tretje fiziologjike; 6. Këshillo pacientin të mbajë kokën mbrapa; 7. Me strisho sterile të preken zonat e inflamuar; 8. Materiali zakonisht merret në këndin e poshtëm të konjunktivës; 9. Rrotullo strishon për 10-15 sekonda për të mbledhë sekretin; 10. Gjatë nxjerrjes së strishos nuk bën të prekët lekura për të evituar kontaminimin me mikrobiomen e lëkurës (florën normale); 11. Tamponi vendoset në kontejner përkatës, i cili mbyllet me kujdes dhe vendoset në mbajtëse të mostrave për transport.
		<ol style="list-style-type: none"> 1. Laboranti sigurohet se mediumet për kulturë janë në përputhje me rregullat për kontroll të cilësisë;

[IV]	Veprimet e laboratorike të kultivimit	<ol style="list-style-type: none"> 2. Laboranti shënjon mediumet me informacionin e numrit identifikues të mostrës (numri i regjistrimit); 3. Laboranti bën inokulimin e strishos me hapjen e kontejnerit të strishos dhe mbjelljen e saj në pllaka Petri (Agar Gjak, Agar qokolad, MacConkey Agar, Tio-Glikolat. 4. Me kërkesë të mjekut udhëzues, kultivimi në medime shtesë i mostrës bëhet varësisht patogjenit sipas Tabelës 1 dhe Figurës 1 të paraqitur në Shtojcën 1; 5. Laboranti vendos pllakat e Petrit me Agar Gjak te inokuluar në tërmostat sipas kushteve në temperaturë 5-10%CO², 37°C dhe MacConkey Agar dhe Tio-glikolat ne tërmostat në temperaturë 37°C me O²; 6. Mostrat varesisht prej Patogjenit përpunohen në medimet ushqyese dhe kushtet e inkubimit sipas Tabelës 2 të paraqitur në shtojcën 1.
[V]	Veprimet e laboratorike të kultivimit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mikrobiologu ekzaminon pas inkubimit 24h të pllakave Petri, praninë e rritjes së bakteve ku kolonitë bakteriale analizohen bazuar në: <ol style="list-style-type: none"> a. madhësi; b. ngjyrë; c. morfologjinë; d. vetitë hemolitike (alfa, beta, ose gamma); e. modelet e inhibicionit të rritjes (p.sh., në MacConkey agar); 2. Nëse mikrobiologu përcakton se kultura ka rezultuar negative në prani të kolonive të bakteve patogjene pas 24-48 h inkubimi, nuk kërkon shtesë për përpunim të mëtejshëm dhe raporton rezultatin si: "Nuk janë izoluar Bakterie Patogjene"; 3. Nëse ka rritje të dyshimtë të kolonive të bakteve patogjene, mikrobiologu specifikon cilat teste adekuate biokimike (ose sisteme të automatizuara), varësisht nga izolati i dyshuar, duhet të performohen dhe t'i shënojë në listën përcjellëse të mostrës. Këto teste biokimike përfshijnë: <ol style="list-style-type: none"> a. Testi i Koagulazës: Dallon speciet mes Staphylococcus aureus (koagulazë pozitive) dhe specieve të tjera të Staphylococcus, sipas Figurës 2 të paraqitur në Shtojcën 1.

		<p>b. Identifikimi i Streptococcus B-haemolyticus sipas algoritmit të punës.</p> <p>c. Sistemi i automatizuar (Vitek) për identifikimin e specieve bakteriale, ose sistemi i specializuar MALDI-TOF për organizma nazeqare;</p> <p>4. Mikrobiologu specifikon llojin e testit të ndjeshmërisë ndaj antimikrobikëve, bazuar në udhëzuesit e EUCAST 2025;</p> <p>5. Laboranti bën përpunimin e mostrës sipas udhëzimeve të mikrobiologut;</p> <p>6. Mostrat e përpunuara vendosen në termostat në kushte të caktuara inkubimi varësisht nga lloji i testit dhe sipas udhëzimit të përdorimit të tyre;</p> <p>7. Mikrobiologu lexon dhe interpreton testet e performuara dhe regjistron të dhënat përfundimtare të testimit.</p>
[VI]	Veprimet e laboratorike të raportimit të rezultatit	<p>1. Laboranti vendos të dhënat e regjistruara në fletëpërcjellëse nga ana e mikrobiologut në sistemin informativ të laboratorit;</p> <p>2. Laboranti vendos të dhënat në librin e protokollit të laboratorit, respektivisht në data bazat përkatëse të laboratorit;</p> <p>3. Mikrobiologu verifikon rezultatet mbi saktësinë e analizave të raportuara nga laboranti, të dhënat për patogenët e identifikuar, testin e ndjeshmërisë dhe çdo koment ose rekomandim shtesë për trajtim (p.sh., ndjeshmëria ndaj antibiotikëve specifikë) sipas interpretimit nga ana e tij.</p>

Shtojca 1

Tabela 1.

Ljoji i mostres	Indikacioni /Detajet klinike	Kushtet e ruajtjes	Mikroorganizmi i kerkuar
Strisho e konjuktives	Konjuktivitis	Kabinetin e Biosigurise II Strisho Amies me terren transportues, Strisho pa terren sterile Temp 22-25°C – max 2h	Staphylococcaa aureus Streptococcus pneumonia Haemophilus influenzae Haemophilus parainfluenzae Moraxella catarrhalis Neisseria gonorrhoeae Neisseria meningitidis Chlamydia trachomatis, Strept. Gr. A,B,C dhe G Enterococcus spp. Klebsiella pneumonia, Proteus mirabillis Pseudomonas aeruginosa
Ne raste specifike me kërkesë të klinicistit			
Blefariti	Pezmatimi i qepallave	Kabinetin e Biosigurise II Strisho Amies me terren transportues Temp 22-25°C – max 2h	Staphylococcus aureus Staphylococcus epidermidis Corynebacterium spp
Keratiti	Inflamacion i kornesë	Strisho Amies me terren transportues / PVC Strisho pa terren .sterile Temp 22-25°C – max 2h	Staphylococcaa aureus Streptococcus pneumonia Pseudomonas aeruginosa Enterobacter spp Aspergillus Candida spp
Endoftalmiti	Inflamacion i segmenteve të përparme dhe të pasme të syrit, trupit qelqor dhe dhomave të syrit. Është i ndarë ekzogjene, e cila është më e zakonshme dhe shfaqet pas traumës ose operacionit, dhe endogjene (metastatike), e cila përhapet në mënyrë hematogjene.	Kabinetin e Biosigurise II Strisho Amies me terren Temp 22-25°C – max 2h *Nuk guxon te futen ne Frigorifer	Staphylococcaa aureus Staphylococcus Koagulase Negative Streptokoket Haemophilus influenzae Proteus mirabillis Pseudomonas aeruginosa Candida albicans Aspergillus spp Bacillus spp Clostridium spp Nocardia spp Actynomyces spp Mycobacterium tuberculosis
Celuliti orbital	Shfaqet pas traumës, operacionit ose pas një infeksioni të sinuseve paranazale	Kabinetin e Biosigurise II Strisho Amies me terren transportues /	Staphylococcaa aureus Streptococcus pneumonia Haemophilus influenza (tipi b) Pseudomonas aeruginosa Strept gr. A

Tabela 2.

Pamja klinike/indikacioni	Mesatarja standarde	Inkubacioni	Leximi i kultures	Në kërkim te mikroorganizmave
Blefariti konjuktivit sy i kuq	1. Agar Gjak 2. Agar Qokollad 3. Endo Agar	35-37 5-10% CO ₂ 40-48 h O ₂ 24-48 h	Ditore	H. influenzae, Streptococcus grupa A,B, C,G Moraxella spp. N. gonorrhoeae N. meningitidis P. aeruginosa Staphylococcus aureus Streptococcus pneumoniae, SKN Corynobacteria
Infeksion gonokoksik të sapolindurit	Agar Qokollad	35-37 5-10% CO ₂ 40-48 h	≥40 h	N. gonorrhoeae
Imunokompromentuar blefariti kronik	Sabouraud agar	28-30 aerobe 40-48 h	≥40 h	Myshqet
Celuliti orbital pas operacionit, traumat	Agar Gjak	35-37 anaerobe 40-48 h 10 d	≥40 orë, ≥40 orë e në vazhdim 7 ditë dhe 10 ditë	Anaerobe aktinomisetet

Figura 1.





Figura 2.



Grafika e Perpunimit

